


REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë mbajtur në fshatin Novolan, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 28.08.2021 me fillim në ora 15:00, në Shkollën "Emin Duraku".
Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës, etj.

Nga banorët e atij lokaliteti ishin të pranishëm 12 pjesëmarrës. Prej tyre 12 meshkuj dhe asnjë femra.

Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtër lidhur me investimet e bëra gjatë këtyre viteve të udhëheqjes së tij me komunën, duke filluar me projektet infrastrukturore si shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Fatmir Kovaçi, kërkon që rruga Bukosh-Novolan të bëhet me trotuar, një fushë sportive, dhe një çerdhe në një të ardhme.
2. Nexhmedin Tahiri, thotë se kanalizimet në disa lagje janë problem që kërkon zgjedhje, sidomos kanalizimi i cili vjen prej Beçiçit.
3. Xhafer Dërguti, kërkon të eliminohet rreziku që ekziston te lumi, i cili është pa mbrojtëse anësore.
4. Besim Arifi, kërkon që lagjja “Flakadani” të rregullohet, si dhe ka ankesë për mungesë të kanalizimit.

Në fund të këtij takimi u theksua se këto kërkesa do të shqyrtohen në ekzekutivin e komunës, Komitetin për politikë dhe financa dhe rekomandohen për miratim në kuvendin e komunës për aprovim varësisht prej prioriteteve që do të përcaktohen si dhe varësisht prej disponueshmërisë buxhetore për investime kapitale për v. 2022-2024.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

